- 7.5.6 Banka nuk zotëron drejtpërdrejtë, ose tërthorazi pjesë të kapitalit, apo aksioneve, të drejta vote në ndonjë shoqëri, ose partneritet, firmë apo grup tjetër, apo ente, shoqëri të thjeshtë të çdo lloji, shqiptare, apo të huaj. Banka nuk gëzon të drejtën dhe nuk ka detyrimin të blejë pjesë kapitalit, apo aksioneve, apo të drejta vote në ndonjë shoqëri tjetër, partneritet, firmë, ose grupe, ente të tjera, shoqëri të thjeshta të çdo lloji, shqiptare ose të huaj.

7.6 Transferimi i Aksioneve te Transkasionit

- 7.6.1 Shitësi është regjistruar si pronar i vetëm i Aksioneve dhe gëzon të drejtën të transferojë aksionet tek çdo person, apo shoqëri pa kufizim.
- 7.6.2 Aksionet janë të lira nga çdo barrë.
- 7.6.3 Të gjitha procedurat e nevojshme për të kryer transferimin e Aksioneve në përputhje me të gjitha ligjet dhe rregulloret e zbatueshme në Datën e Mbylljes janë zbatuar në mënyrën e duhur nga Shitësi.
- 7.6.4 Aksionet e Shitesit janë 425.334 aksione me të drejtë vote, me vlerë nominale ALL 3.220,039 secili, që përfaqësojnë 72.204% të kapitalit dhe të drejtat e votës së Bankës.

7.7 Dokumentet e nevojshme ligjore

- 7.7.1 Të gjitha librat e kontabilitetit, dokumentet ligjore dhe dosjet e kërkuara nga ligjet dhe rregulloret e zbatueshme mbahen nga Banka dhe posedohen prej saj, dhe përmbajnë informacion të vërtetë dhe të saktë në thelb dhe janë të regjistruara në mënyrën e duhur sipas parimeve të përgjithshme të pranuara të zbatueshme për Bankën.
- 7.7.2 Të gjitha vërtetimet, ose dokumente të tjera, të cilat provojnë pronësinë e aseteve nga Banka dhe kopjet e nënshkruara të të gjitha kontratave të lidhura prej tyre, të cilat janë në fuqi, posedohen nga Banka, ose janë nën kontrollin e saj.

7.8 Përputhshmëria me Ligjet dhe Rregulloret

- 7.8.1 Banka kryen veprimtari bankare në Shqipëri. Banka ka të gjithë autorizimet e nevojshme për pronësinë mbi asetet e saj dhe për ushtrimin e aktivitetit të saj. Banka dhe drejtuesit e saj janë në përputhje me të gjitha ligjet e zbatueshme për këtë veprimtari në Shqipëri, veçanërisht me të gjitha



rregulloret për bankat, si dhe me të gjitha kushtet për sa u përket lejeve dhe autorizimeve të nevojshme.

7.8.2 Veçanërisht;

- (a) veprimtaria e Bankës është kryer në thelb në përputhje me (i) Autorizimet; (ii) rregullat e zbatueshme, përfshirë rregullat për parandalimin e pastrimit të parave dhe rregullat e zbatueshme të detyrueshme të huaja; (iii) rregulloret e Bankës; dhe (iv) rregullat e brendshme të Bankës për drejtimin e shoqërisë;
- (b) nuk kërkohet investim shtesë, ose ndonjë veprim në mënyrë që Banka të jetë në përputhje me ligjet e zbatueshme, ose rregullat e zbatueshme të detyrueshme të huaja;
- (c) Autorizimet janë në fuqi të plotë dhe janë të pakushtëzuara apo të kufizuara në kohë;
- (d) Banka nuk ka marrë ndonjë njoftim për ndonjë ndryshim të propozuar të pafavorshëm të Autorizimeve dhe për sa Shitësi dhe Banka janë në dijeni, nuk do të ketë ndryshime të planifikuara, apo të kërcënuara të pafavorshme të Autorizimeve, me përjashtim të atyre që zbatohen në përgjithësi për bankat në Shqipëri.
- (e) nuk ka raste të cilat mund shkaktojnë revokimin, apo pezullimin a Autorizimeve, apo që mund të përfshijnë përgjegjësinë e Bankës, apo të drejtorëve, ose të punëmarrësve, veçanërisht për shkak se është shkelur rregullorja për Autorizimet.
- (f) transferimi i pronësisë së Aksioneve tek Blerësi nuk do të shkaktojë revokimin apo pezullimin e licencës apo të autorizimit të nevojshëm për ushtrimin e veprimtarisë së Bankës.
- (g) i gjithë informacioni dhe librat e kontabilitetit që u janë dërguar Autoriteteve Qeveritare nga Banka kanë qenë të plotë, të vërtetë dhe të saktë.

7.8.3 Banka është në përputhje me të gjitha ligjet e zbatueshme në lidhje me parandalimin e pastrimit të parave, pa konsideruar vonesa teknike të arsyeshme, ose gabime të vogla. As Shitësi dhe as Blerësi dhe as ndonjë drejtor, nëpunës, apo punëmarrës i tyre të autorizuar, agjent apo përfaqësues, ka:

- a. paguar, premtuar të paguajë apo ofruar për të paguar, ose autorizuar pagesën e ndonjë komisioni, ryshfeti, pagese apo shperblimi në lidhje me transaksionin e kësaj Kontrate që shkel ligjin e zbatueshëm, apo ka lidhur ndonjë kontratë, si pasojë e të ciles duhet ndonjë komision i tillë, ryshfet, pagesë apo shpërblim do të mund apo që do të paguhet në çdo kohë;
- b. ofruar ose dhënë ndonjë send me vlerë për të ndikuar në veprimet e zyrtarit publik, ose ka kërcënuar ndonjë person, pronë ose reputacionin, lidhur me transaksionin sipas kësaj Kontrate, në mënyrë që të marrë apo përfitojë avantazhe biznesi, apo avantazhe të tjera të papërshtatshme për kryerjen e veprimtarisë.

7.8.4 Bizneset e Bankës, veprimtaria, asetet, pajisjet, pronat, kontratat e qirave dhe pasuri të tjera (përfshirë asetet të cilat Banka i disponon perkohesisht si pasojë e venies në posedim të aseteve të barresuara/hipotekuara në favor të saj) janë në përputhje me dispozitat e të gjithë ligjeve të ruajtjes së mjedisit, mbrojtjes së shëndetit dhe sigurisë që janë të zbatueshme. Banka është pajisur me gjithë autorizimet e nevojshme, dhe nuk ka marrë asnjë ankese, urdher, direktive, padi, citim, apo njoftim nga ndonjë autoritet shtetëror në lidhje me ndotjen e ajrit, rrjedhje uji në sipërfaqe apo nëntokë, ndotje



MM

akustike, shperndarje mbeturinash, perdorimin, prodhimin, ruajtjen, transportimin apo shperndarjen e substancave toksike apo te rrezikshme apo shperdorime apo ceshtje te tjera te tjera te mjedisit, shendetit apo sigurise.

- 7.8.5 Të gjitha vendimet e marra nga organet drejtuese të Bankës (mbledhjet e asamblese se pergjithshme te aksionereve, keshilli drejtues), janë marrë gjithmone në përputhje me ligjin.

7.9 Mungesa e Konfliktit dhe Mungesa e Ndikimit Negativ

Nënshkrimi, dorëzimi dhe përmbushja e kësaj Kontrate nuk do të:

- a. rezultojë në përshpejtimin e pagesës, pezullimit, ndryshimin ose rinegocimit të financimeve;
- b. rezultojë në zgjidhjen e parakohshme, pezullimin, ndryshimin, ose rinegocimin e ndonjë marrëveshjeje të rëndësishme në të cilën Banka është palë;
- c. rezultojë në ndryshimin, pezullimin, mos-rinovimin, anulimin, ose revokimin e autorizimeve;
- d. rezultojë në çlirimin e ndonjë garancie, barre siguruese, ose angazhimi tjetër të ngjashëm (si letra garancie), të cilat janë dhënë në favor të Bankës;
- e. rezultojë në pagesën e ndonjë gjobe financiare;
- f. këtë ndikim thelbësor të pafavorshëm mbi aftësinë e Bankës për të ushtruar Rrjedhën e Zakonshme të Veprimtarisë.


7.10 Pasqyrat Financiare

- 7.10.1 Bilanci, libri i fitimeve dhe humbjeve (duke përfshirë anekset) dhe detyrimet jashtë bilancit të Bankës, më 30 Qershor 2020 dhe me 31 Dhjetor 2019 ("Pasqyrat Financiare për Vitin 2019"), i cili bashkëngjitet si Shtojca 7.10.1, janë përgatitur ne përputhje me IFRS, te cilat aplikohen ne vazhdimesi nga Banka, dhe paraqesin besnikërisht në çdo aspekt asetet dhe detyrimet, situatën financiare dhe rezultatet e Bankës për datat përkatëse.
- 7.10.2 Në veçanti, Banka nuk ka borxhe apo detyrime, qoftë ekzistuese, me kusht, ose të mundshme, të cilat nuk përfshihen në Pasqyrat Financiare për Vitin 2019, si rrjedhojë e disa ngjarjeve të cilat kanë ndodhur, ose ishin të parashikueshme më datë, ose përpara datës 31 Dhjetor 2019 ose si pasojë e një, ose disa veprimeve të mbyllura, ose në proces për t'u mbyllur më datë, ose përpara datës 31 Dhjetor 2019 dhe veçanërisht, nuk ka borxh tregtar, tatimor, administrativ, ose të sigurimeve shoqërore ose detyrime, as edhe ndonjë taksë, interes, penalitet apo gjobë, as edhe detyrime jashtë bilancit (garanci, të drejta blerjeje të dhëna të tretëve, etj.);
- i. Të gjitha asetet e regjistruara në Pasqyrat Financiare për 2019 janë pronë e Bankës. Të gjitha të arketueshmet dhe financimet janë dhene bazuar ne parimet e shendosha te kredise dhe jane marre masat e duhura te brendshme dhe rregullatore ne lidhje me borxhet.

7.11 Kontratat

- 7.11.1 Banka është e detyruar të zbatojë të gjitha kontratat e saj në fuqi. Banka ka përmbushur dhe do të përmbushë të gjitha detyrimet e saj sipas këtyre kontratave. Nuk ka asnjë rast që mund (i) të rezultojë në anulimin, ose zgjidhjen e këtyre kontratave (ii) t'i japë të drejtën palës së tretë të kërkojë një pagesë të

14



MM

parakohëshme, ose (iii) të përfshijë në ndonjë mënyrë përgjegjësinë e Bankës, të drejtorëve të saj dhe/ose të punëmarrësve, përveç rasteve të listuara në nenin 7.11.1.

- 7.11.2 Transferimi i Aksioneve as nuk do të rrisë detyrimet kontraktuale të Bankës ndaj palëve të treta dhe as nuk do të kufizojë të drejtat e tyre kontraktuale kundrejt paleve të treta.
- 7.11.3 Të gjitha kontratat në të cilat Banka është palë janë në formën e dokumenteve ligjore, të cilat lejojnë Bankën të ushtrojë të gjitha të drejtat e saj.

7.12 Interesa mbi Kolaterale dhe Garancite

- 7.12.1 Të gjithë mjetet e sigurimit, kolaterale dhe garancite që janë në fuqi në datën e kësaj Kontrate (në vazhdim quajtur **Mjetet e Sigurimit**), që i bashkëngjiten marrëveshjeve të financimeve, leter garancive, dhe angazhime të tjera të ngjashme, në bazë të të cilave, detyrimi ndaj Bankës tejkalon shumën 18,000,000 Leke, të dhëna Bankës dhe që sigurojnë përmbushjen nga palët e tjera të gjithë detyrimeve kontraktuale që rrjedhin nga to (dhe në vecanti por pa u kufizuar në, rimbursimet e financimeve) janë të plota.
- 7.12.2 Të gjitha Mjetet e Sigurimit të referuara në nenin 7.12.1 janë të vlefshme, të detyrueshme dhe në fuqi dhe efekt të plote dhe krijojnë të drejta të vlefshme në favor të Bankës dhe janë të vlefshme dhe detyrime të vlefshme mbi huamarrësit e tyre.
- 7.12.3 Në datën e Mbylljes ose përpara saj, nuk do të bëhet apo të lihet pa bërë nga Banka ose për llogari të saj, asnjë veprim që do të ose mund të zhvlerësojë ndonjë nga Mjetet e Sigurimit apo të ulë aftësinë e Bankës për të vënë në ekzekutim Mjetet e Sigurimit në përputhje me kushtet e percaktuara nga to.

7.13 Kontrata jashtë Rrjedhes së Zakonshme të Veprimtarisë, Detyrime Financiare, Kontrata me Aksionerët

Përveç sa tregohet në Pasqyrat Financiare për Vitin 2019, Banka nuk ka:

- lidhur ndonjë marrëveshje jashtë Rrjedhes së Zakonshme të Veprimtarisë ose që do të përfshinte përgjegjësinë e saj të përbashkët ose të pakufizuar;
- lidhur ndonjë marrëveshje e cila mund të përfundojë me heret si pasojë e transferimit të aksioneve të transaksionit;
- lidhur ndonjë marrëveshje që parashikon një njoftim paraprak për ndërprerje që tejkalon tre (3) muaj ose një demshperblim për përfundim të parakohshëm me të lartë se 5,000,000 Leke;
- lidhur ndonjë marrëveshje me Shitesin ose me ndonjë kompani në të cilën Shitesi ka shumicë interesi dhe/ose me ndonjë kompani në të cilën Shitesi mban një vend në organet drejtuese;
- shkaktuar, kundrejt Shitesit ose ndonjë kompanie në të cilën Shitesi ka një shumicë interesi, ndonjë detyrim ose borxh, të ndryshëm nga ato të shkaktuara gjatë Rrjedhes së Zakonshme të Veprimtarisë dhe nën kushte normale tregu.

7.14 Detyrime dhe Garanci jashtë bilancit

Përveç siç tregohet në "Librin e Llogarive për vitin 2019", asnjë garanci, peng, sponsorizim, leter garancie apo angazhime të ngjashme dhe asnjë detyrim jashtë bilancit i çfarëdo natyre, e dhënë nga

15




MM

Banka apo shkaktuar asaj, nuk eshte dhe nuk do te jete ne fuqi ne Daten e Mbylljes.

7.15 Marrëveshje për Ndarje të Fitimit

Banka nuk është palë dhe as nuk ka pranuar të jetë palë në ndonjë marrëveshje, e cila i jep ndonjë palë të tretë të drejtën për të ndarë tërësisht ose pjesërisht fitimin e Bankës.

7.16 Klientët

Banka nuk ka marrë asnjë informacion, sipas të cilit ndonjë klient që kontribuon konsiderueshem në fitimin e saj, të ketë bërë të njohur qëllimin e tij për të përfunduar ose reduktuar në mënyrë të ndjeshme në të ardhmen marrëdhëniet e tij tregtare me Bankën, veçanërisht lidhur me transferimin e Aksioneve.

7.17 Falimentimi

7.17.1 Asnjë individ nuk është emëruar për të administruar të gjithë, ose një pjesë të aseteve të Bankës.

7.17.2 Asnjë kërkesë apo deklaratë nuk është bërë për riorganizimin apo likuidimin në rrugë gjyqësore të Bankës, apo për shpërndarjen dhe likuidimin e pershpejtuar të Bankës.

7.17.3 Banka nuk është objekt i procedurave në rrugë gjyqësore, apo me pajtim për falimentim, likuidim të detyrueshëm, mbylljeje aktiviteti, apo likuidimi (vullnetar ose jo), as nuk ka ndërprerë kryerjen e pagesave kreditorëve dhe as nuk është në kushtet e falimentimit apo të paaftësisë për të paguar borxhet e saj.

7.18 Çështje Gjyqësore

7.18.1 Përveç atyre të njoftura dhe deklaruar tek auditoret e saj sipas ligjit, Banka nuk është e përfshirë në çështje gjyqësore, penale, administrative, ose arbitrazhi, si paditës ose i paditur, në të cilat rreziku i humbjes tejkalon shumën 5,000,000 Lekë.

7.18.2 Nuk ekzistojnë fakte përpara kësaj date, të cilat do të çonin në nisjen e procedurave kundër Bankës, ose kundër drejtorëve të saj, punëmarrësve, ose ish-drejtorëve, ose ish-punëmarrësve, për të cilat Banka do të ishte përgjegjëse.

7.18.3 Veçanërisht, Banka nuk është palë dhe as nuk kërcënohet nga ndonjë kërkesë padi që mund të ngrihet nga klientët, ose palët e treta.

7.18.4 Për më tepër, nuk ka vendime gjyqësore, ose administrative, urdhra, dhe as afate kohore që i janë lënë Bankës nga ndonjë organizatë profesionale, ose autoritet mbikëqyrës, duke i vendosur Bankës një detyrim, i cili në të ardhmen mund të shkaktonte pasoja të pafavorshme në rrjedhën normale të veprimtarisë.

7.19 Punonjesit, Perfaqesuesit e Bankes

7.19.1 Nje liste e te gjithë anetareve te organeve drejtuese dhe bordit te drejtoresh te Bankes i jepet Bleresit ne Daten e Nenshkrimimit, se bashku me nje tregues te plote te kompensimit te tyre, shperblimeve, perfitimeve dytesore, paketave te shkeputjes, parashutave te arta dhe/ose ndonje dispozite tjeter qe zbatohet ne rast te zgjidhjes se kontratave te punes, pushimit nga detyrat e mbajtura ne Banke per cfaredo arsye.

16

REPUBLIKA E SHQIPËS
PËRKTHYES Z. KAMBE
Thodhori Kambe
Përkthyes
OFFER

MS

- 7.19.2 Nuk ka asnje shume te detyrueshme per t'iu paguar ndonje punonjesi aktual ose te meparshem, agjenti apo perfaqesuesi te Bankes ne lidhje me punesimin e tyre dhe/ose kontrata ose marreveshje te tjera, pervec te drejtave per pagesat e llogaritura por qe ende nuk jane te pagueshme ose shlyerjen e shpenzimeve profesionale, ose borxhet e pershkruara ne Llogari. Punonjesit aktuale te Bankes, se bashku me nje tregues te moshes dhe vjetersise se tyre, listohen ne nen-nenin 7.19.2. Nuk eshte dhene asnje premtim per te punesuar ndonje person, pervec gjate Rrjedhes se Zakonshme te Veprimitarise;
- 7.19.3 Banka nuk ka paguar ose ka rene dakord te paguaje ndonje shume te cfaredo lloji qe nuk eshte subjekt i taksave, ndonjerit prej punonjesve, agjenteve apo perfaqesuesve te saj.
- 7.19.4 Banka nuk ka shkaktuar asnje detyrim te cfaredo lloji ndaj ish-punonjesve, vecanerisht detyrime te papermbushura qe rrjedhin nga shkelja e ndonje kontrate pune ose sherbimi apo nga demshperblime per pushimin nga puna apo demshperblime per pushim te pajustificuar nga puna apo nga mosrespektimi i detyrimit per te rikthyer ne pune nje punonjes;
- 7.19.5 Banka ka permbushur te gjitha udhezimet dhe detyrimet e vendosura nga autoritetet kompetente ne fushat e punesimit, sigurimeve shoqerore, shendetit dhe sigurise ne pun esi dhe gjithë ligjet dhe rregulloret e zbatueshme per punesimin;
- 7.19.6 Rregulloret ne lidhje me kolektivat dhe sindikatat e punes dhe perfaqesimin e punonjesve ne Banke jane respektuar si duhet;
- 7.19.7 Pervec atyre per te cilat Bleresi eshte informuar, nuk eshte lidhur asnje kontrate pune me ndonje punonjes aktual apo te meparshem, perfaqesues apo agjent, qe te permbaje dispozita te nje natyre apo kohezgjatje te jashtezakonshme, ose dispozita te cilat jane me te favorshme se ato te parashikuara nga ligjet dhe rregulloret e zbatueshme dhe nga marreveshja e negociatave kolektive e zbatueshme per Banken.
- 7.19.8 Ekzekutimi i kesaj Kontrate nuk do te shkaktoje per Banken asnje detyrim apo pergjegjesi te cfaredo natyre, pervec atyre te permendura ne Librin e Llogarive për vitin 2019, te cilat jane kontabilizuar plotesisht sic duhet ne Librin e Llogarive për vitin 2019.

7.20 Pensions

Te gjitha kontributet e pagueshme dhe te detyrueshme per pagese nga Banka, sipas planeve te pensioneve dhe perfitimeve dhe gjithë detyrimet e ardhshme te Bankes nën to, jane paguar ne menyre te rregullt ose jane siguruar fondet për tu paguar.

7.21 Prona Reale dhe Personale

- 7.21.1 Banka disponon tituj te mire dhe te vlefshem, te regjistruar sipas kerkesave ne regjistrin e pasurive te paluajtshme, mbi gjithë pasurite e paluajtshme te listuara ne Shtojcen 7.21.1, qe eshte lista e plote e pasurive te paluajtshme ne pronesi ose te dhena me qira nga Banka ne daten e raportimit. Keto pasuri te paluajtshme te listuara ne Shtojcen 7.21.1 jane te lira dhe pa asnje barre.
- 7.21.2 Pasurite e paluajtshme qe posedohen nga Banka, qofshin ne pronesi te saj ose jo, jane ne gjendje normale fizike, te pershtatshme per perdorimin aktual nga Banka, dhe Banka ka akses te lire tek keto pasuri te paluajtshme, pa pasur nevojë qe te merren veprime te metejshme, duke perfshire por pa u kufizuar ne krijimin e lehtesive.

7.21.3 Asnje nga pasurite e paluajtshme qe jane ne posedim te Bankes, qofshin ne pronesi te saj ose qe perdoren prej saj, nuk perben rrezik apo shkel ndonje ligj te zbatueshem ne ndonje aspekt.

7.21.4 Banka nuk eshte e angazhuar per te blere ndonje pasuri te paluajtshme.

7.22 Qirate

Ne lidhje me pronat e paluajtshme te dhena me qira nga Banka dhe listuar ne Librin e Llogarive për vitin 2019:

- a. Banka ka permbushur te gjitha detyrimet e saj qe rrjedhin nga marreveshjet e qirase ne lidhje me pasurite e paluajtshme operationale ne te cilat eshte pale;
- b. asnje e drejte posedimi apo gezimi nuk eshte fituar apo eshte ne process per tu fituar nga nje pale e trete, dhe as nuk i eshte dhene ndonje pale te trete nje e drejte e tille;
- c. Banka ka titull te vlefshem per te perdorur te gjitha pronat e tjera te paluajtshme qe perdor aktualisht, por qe nuk i ka ne pronesi, ne baze te qirase dhe ky titull eshte i lire dhe i paster nga cdo barre pervec kufizimeve te percaktuara ne qirate e pronave ne te cilat Banka eshte qiramarrese, kufizime te cilat nuk ndikojne materialisht dhe negativisht ne aftesine e Bankes per te kryer veprimtari ne Rrjedhen e Zakonshme te Veprimtarise;
- d. Qiradhenesi ka titull te vlefshem pronesia mbi keto prona te paluajtshme.

7.23 Te Drejtat e Pronesise Intelektuale dhe IT

7.23.1 Banka zoteron te Drejtat e Pronesise Intelektuale mbi aktivet e perdorura aktualisht dhe Banka ka permbushur te gjitha formalitetet dhe ka kryer te gjitha pagesat per te siguruar mbrojtjen e vazhdueshme te te Drejtave te Pronesise Intelektuale ne perputhje me ligjet dhe rregulloret e zbatueshme.

7.23.2 Banka ka licence te vlefshme ose pelqim per perdorim mbi te gjitha te Drejtat e Pronesise Intelektuale qe i ka ne perdorim, por jo ne pronesi. Banka nuk eshte ne mospermbushje materiale nen kete licence apo pelqim dhe as nuk ka shkelur ndonje te Drejte Pronesia Intelektuale te zotuar nga palet e treta.

7.23.3 Banka nuk eshte ne mospermbushje materiale nen marreveshjet e lidhura nga Banka ne lidhje me Sistemet IT, perfshire por pa u kufizuar ne licencat e programeve dhe marreveshjet per blerjen e pajisjeve elektronike dhe Banka nuk ka marre apo dhene ndonje njoftim per mospermbushje nen to.

7.23.4 Banka nuk eshte angazhuar per t'i dhene ndonje pale te trete ndonje te drejte perdorimi mbi te Drejtat e Pronesise Intelektuale.

7.24 Sigurimi

7.24.1 Banka eshte e siguruar nga policat ne fuqi, primet e te cilave jane paguar ne kohen e duhur dhe qe mbulojne ne kushte normale rreziqet qe pesojne rregullisht kompanite te cilat zhvillojne nje veprimtari te ngjashme me ate te Bankes ne Shqiperi. Banka nuk ka kryer apo lene pa kryer ndonje veprim i cili mund te shkaktojte pavlefshmerine e ketyre policave te sigurimit ose qe mund te sjelle anullimin e tyre;

7.24.2 Deri tani nuk ekziston asnje padi ne lidhje me aplikimin e policave te sigurimit te Bankes, dhe nuk ka ndodhur asnje ngjarje qe mund te sjelle nje padi te tille;



mn

7.25 Prokurat dhe Autorizimet

Banka nuk ka lëshuar prokurë apo autorizim të drejtpërdrejtë apo të nënkuptuar, të cilët të jenë ende në fuqi, për të lidhur kontrata apo për të marrë përsipër detyrime në emër të Bankës, me përjashtim të të drejtës, që u jepet punëmarrësve të shoqërive për të ushtruar funksionet e tyre normale në Rrjedhën e Zakonshme të Veprimtarisë.

7.26 Dokumentet për Deklarimin e Detyrimeve Tatimore dhe të Tjera

7.26.1 Përveç sa permendur ne nen-nenin **Error! Reference source not found.**:

- (a) Banka ka depozituar rregullisht dhe në kohë të gjitha dokumentet e kërkuara për deklarimin e detyrimeve Tatimore dhe të sigurimeve shoqërore; dhe
- (b) Banka ka paguar, ose ka siguruar fondet për të paguar të gjitha detyrimet Tatimore dhe të sigurimeve shoqërore, përfshirë interesin, gjokat e të tjera. Këto fonde vlejné për të paguar të gjitha detyrimet Tatimore dhe/ose të sigurimeve shoqërore që mund të bëhen të pagueshme pas datës së kësaj Kontratë për periudhën përpara Datës së Mbylljes.

7.26.2 Banka nuk përfiton nga ndonjë marrëveshje e vecantë ose periudhë mospagimi që shtyn afatin e pagimit përse i përket detyrimeve të kërkuara Tatimore dhe të sigurimeve shoqërore.

7.26.3 Me përjashtim të inspektimeve të zakonshme nga Banka e Shqipërisë, Banka nuk ka qenë objekt inspektimi, apo hetimi dhe nuk ka marrë ndonjë kërkesë për informacion, ose njoftim nga autoritetet tatimore, apo të sigurimeve shoqërore dhe as nuk priten inspektime, apo hetime të tilla.

7.26.4 Nuk ka asnjë konflikt aktual me ndonjë autoritet shtetëror përse u përket detyrimeve tatimore, doganore, apo të sigurimeve shoqërore dhe nuk ka asnjë arsye të besohet, që mund të ketë ndonjë konflikt të tillë.

7.27 Të Ardhurat e Arkëtueshme

7.27.1 Banka ka titull të vlefshëm mbi të gjitha të ardhurat e arkëtueshme (**Te Ardhura te Arketueshme**) të regjistruara në librat e saj më datë 31 Dhjetor 2019, ato janë të lira nga cdo barre dhe përse Shitësi është në dijeni, ka të gjitha dokumentet origjinale, që vërtetojnë këto tituj. Këto të Ardhura të Arkëtueshme janë të vlefshme dhe të detyrueshme për debitorin përkatës.

7.27.2 Të gjitha barrët siguroese, ose garancitë e dhëna në favor të Bankës për të siguruar pagesën e të Ardhurave të Arkëtueshme janë dhënë në mënyrë të vlefshme dhe janë ndërmarrë të gjitha hapat për të qenë të detyrueshme ndaj palëve të treta, në përputhje me ligjet e zbatueshme dhe rregullave të detyrueshme të zbatueshme të huaja.

7.28 Transaksionet me Personat e Lidhur

7.28.1 Banka nuk ka lidhur dhe nuk është angazhuar të lidhë marrëveshje të çfarëdolloj natyre me ndonjë nga personat e lidhur, ose me palët e treta për të siguruar, ose garantuar detyrimet e Personave të Lidhur;

7.28.2 Huatë e dhëna nga Banka për Personat e Lidhur janë dhënë kryesisht me të njëjtat kushte dhe afate si ato për personat jo-të lidhur (me status dhe besueshmëri të njëjtë) dhe në përputhje me rregullat bankare të zbatueshme në Shqipëri.



7.29 Informacioni dhe Dokumentet

Informacioni dhe dokumentet, që përmban kjo Kontratë dhe Shtojcat e saj janë të vërteta, të përditësuara dhe të plota deri në këtë datë.

7.30 Te ndryshme

- 7.30.1 Banka nuk ka punësuar ndonjë agjent apo ndermarre ndonjë detyrim për ndonjë tarife apo komision agjencie në lidhje me transaksionin e parashikuar këtu.
- 7.30.2 Pa ndikuar në angazhimet e Shitesit si më poshtë, Shitesi i ka vënë në dispozicion Blerësit, me gjithë detajet e nevojshme, të gjitha informacionet materiale që një blerës i aksioneve të Bankes do të prishte të merrte zakonisht përpara se të procedohet me transaksionin e parashikuar në këtë Kontratë.

8. DEKLARIMET DHE GARANTIMET E BLERËSIT

Blerësi deklaron dhe garanton Shitësin, që deklaratimet dhe garantimet e mëposhtme janë të vërteta dhe të sakta në këtë datë dhe do të jenë të vërteta dhe të sakta deri në Datën e Mbylljes:

- a. Blerësi është i organizuar dhe ekziston në mënyrë të vlefshme dhe në gjendje të mirë, në përputhje me ligje e shtetit të tij;
- b. kjo Kontratë përbën një detyrim ligjor, të vlefshëm dhe detyrues për Blerësin, e zbatueshme për Blerësin, e ekzekutueshme kundrejt Blerësit, në përputhje me kushtet e saj. Blerësi ka autoritetin dhe aftësinë të nënshkruajë dhe dorëzojë këtë Kontratë dhe të përmbushë detyrimet e tij që burojnë prej saj.
- c. nënshkrimi, dorëzimi dhe përmbushja e kësaj Kontrate nga Blerësi është autorizuar në mënyrën e duhur dhe të vlefshme nga të gjitha veprimet e nevojshme të Blerësit, në përputhje me themelet e qeverisjes së tij dhe dokumenteve të tij kryesore dhe nuk do të rezultojë në shkelje, apo mospërmbushje të ndonjë marrëveshjeje, apo vendimi gjyqësor ku Blerësi është palë, ose të cilat janë detyruese për Blerësin dhe ekzekutimi i të cilave do të ndikojë në mënyrë të pafavorshme në aftësinë e Blerësit për të përmbushur kushtet e kësaj Kontrate.
- d. nënshkruesit e kësaj Kontrate në emër të Blerësit janë autorizuar në mënyrën e duhur për të nënshkruar këtë Kontratë në emër të Blerësit.
- e. veprimet dhe kërkesat e Blerësit në zbatim të kësaj Kontrate, nuk do të konsiderohen se ndryshojnë negativisht objektivat aktuale operacionale të Bankes të cilat bazohen në parimet e Sharias.
- f. Pavarësisht gjithçkaje që mund të jetë e kundërt këtu, me nënshkrimin e kësaj Kontrate, Blerësi merr përsipër të bëjë hetim dhe vlerësim të pavarur të pershtatshmërisë së këtij transaksioni; dhe të bëjë vlerësimin e tij të pavarur, vlerësimin e cilësive dhe hetimin e të gjitha rreziqeve që rrjedhin apo lidhen qëllimisht e kësaj Kontrate.

9. KUSHTET E ZBATUESHME PËR GARANTIMET

9.1 Kushte të Përgjithshme

- 9.1.1 Palet këtu garantojnë dhe deklarojnë, sipas kushteve të Garancive dhe njohin e pranojnë se të dyja Palet lidhin këtë Kontratë në mbështetje të secilës prej Garancive.



1191

- 9.1.2 Garancite janë dhënë sipas çështjeve të treguara besnikërisht në këtë Kontratë, por asnjë informacion tjetër lidhur me Bankën për të cilën Blerësi është në dijeni (aktuale, ose në proces), përfshirë por jo kufizuar me informacionin e përmbajtur në bazën e të dhënave, nuk do të çënojë ndonjë nga pretendimet e bëra nga Blerësi në bazë të Garancive dhe as nuk do të shkaktojë reduktimin e shumave të rikuperueshme. Për këtë qëllim dhe për të gjitha qëllimet sipas kësaj Kontrate, shprehja "**deklaruar**" do të thotë deklaruar drejt, në një mënyrë të tillë dhe në ato detaje që të mundësojë Blerësin që të bëjë një vlerësim të saktë dhe të bazuar për çështjen në fjalë.
- 9.1.3 Secili nga Garancite do të jetë i veçantë dhe i pavarur dhe, përveç rastit kur parashikohet shprehimisht, nuk do të kufizohet duke iu referuar Garancive të tjera, apo çfarëdo qoftë në këtë Kontratë.

9.2 Kërkesa nën Garantimet ose që lidhen me to

9.2.1 Shitesi ketu angazhohet t'i paguaje Blerësit, në bazë të kërkesës, sipas zgjedhjes së Blerësit:

- 100% të Humbjeve sipas Librit të Llogarive për vitin 2019, ose pjesën e këtyre humbjeve që tejkalon shumën e llogaritur ose parashikuar në Librin e Llogarive për vitin 2019 që mund të rezultojë prej ndonjë kontrolli administrativ, tatimor, doganor ose nga sigurimet shoqërore kundrejt Bankës në lidhje me periudhën përpara Dates së Mbylljes; dhe
- 100% të gjithë Humbjeve të pesuara nga Banka dhe/ose nga Blerësi dhe që lindin ose rezultojnë nga ndonjë mos-perputhje, mosveprim ose pasaktësi në lidhje me cilindo nga Garantimet.

9.2.2 Përveç rasteve të mashtrimeve, neglizhencës së rëndë, sjellës së keqe të qëllimshme ose fshehjes së qëllimshme nga Shitesi, përgjegjësia e Shitesit në lidhje me ndonjë Humbje nën Garantimet do të kufizohet siç përcaktohet në këto klauzole 9 (Kushtet që aplikohen për Garantimet):

- Shitesi nuk do të jetë përgjegjës për sa i përket ndonjë Humbje nën Garantimet, nëse nuk ka marrë nga Blerësi dhe/ose Banka ndonjë njoftim me shkrim në përputhje me përcaktimet e nen-klauzoles 9.5 (Njoftimi për Shitesin), që jep detaje të arsyeshme të Humbjes përkatëse (edhe nëse është vetëm pjesore) dhe përfshin, nëse është e zbatueshme, vlerësimin e shumës së Humbjes, mbi ose nga:
 - për sa i përket transferimit, pronësive dhe titullit ligjor të Aksioneve, fundin e ligjit përkatës Shqiptar për periudhën e kufizimit që aplikohet mbi titujt ligjor dhe transferimin dhe pronësinë e Aksioneve;
 - për sa i përket nen-klauzoles 7.26 (Taksat dhe detyrime Tatimore të tjera), fundin e ligjit përkatës Shqiptar për periudhën e kufizimit; dhe
 - për sa i përket çdo Humbjeje tjetër, data e të cilit është tetëmbëdhjetë (18) muaj kalendarik pas Dates së Mbylljes.

Kjo nenkupton që Humbjet (edhe nëse pjesore në kohën e njoftimit) të njoftuara në datat e perfundimit të përmendura nën (i), (ii) dhe (iii) ose përpara tyre, do ta kalojnë këto date perfundimi.

- Shitesi nuk do të jetë përgjegjës për sa i përket ndonjë Humbje nën Garantimet:
 - nëse dhe në masën që kjo përgjegjësi lind ose rritet si rezultat i ndonjë veprimi ose mosveprimi të Blerësit pas Mbylljes; ose



HN

ii. nese dhe ne masen qe kjo pergjegjesi lind ose rritet si rezultat i ndonje ndryshimi nen IFRS qe do te kerkonte nje riklasifikim te pasqyrave financiare per ndonje periudhe deri ne Daten e Mbylljes, duke perfshire dhe kete date.

- c. Shitesi nuk do te jete pergjegjes per sa i perket ndonje Humbje nen Garantimet, nese dhe ne masen qe Bleresi ose Banka kane te drejte te kerkojne ne lidhje me ndonje Humbje ose dëm te pesuar prej ndonjerit prej tyre qe lindin nga shkelja e Garantimeve sipas kushteve te ndonje police sigurimi ne kohen qe ka qene ne fuqi;
- d. Shitesi nuk do te jete pergjegjes per sa i perket ndonje Humbje nen Garantimet, i cili, ne kohen qe Humbja i njoftohet Shitesit sipas parashikimeve te nen-klauzoles 9.2.1 (a), eshte vetem pjesor. Ne kete rast Shitesi nuk do te jete i detyruar per te kryer ndonje pagese ne lidhje me kete Humbje, nese kjo Humbje nuk behet aktuale brenda dymbedhjete (12) muajsh pas dates se Njoftimit te Kerkeses.

9.3 Kufiri i Pergjegjesise

- 9.3.1 Pervec Humbjeve qe lindin ose lidhen me nen-klauzolat 7.2 (Regjistrimi i Bankes) deri ne 7.6 (Transferimi i Aksioneve), dhe pavaresisht nen-klauzoles 9.2.1 (a)(i) dhe (ii), pergjegjesia e pergjithshme e Shitesit ne lidhje me ndonje Humbje nen Garantimet, nuk do te tejkalojte 5% te Cmimit te Blerjes sic percaktohet ne nen-klauzolen 2.2.1

9.4 Jo Dublikim i Rikuperimit

Bleresi dhe/ose Banka nuk do te kete te drejte te rikuperoje demet ose te rimbursohet me shume se nje here per sa i perket te njejtës humbje.

9.5 Njoftimi per Shitesin

- 9.5.1 Nese merret ndonje vleresim ose Humbje (edhe nese pjesore), ose ndonje ceshtje ose rrethane vjen ne vemendje te Bleresit ose Bankes per te cilin Bleresi ose Banka eshte ne dijeni, Shitesi mund te jete pergjegjes nen Garantimet:
- a. Bleresi do t'i jape njoftim te shkruar perfaqesuesit te Shitesit (per llogari te Shitesit) ose do te sjelle si pasojë qe Banka t'i jape njoftim me shkrim per kete perfaqesuesit te Shitesit (per llogari te Shitesit) brenda dyzet (40) Dite Pune nga marrja dijeni per te (**Njoftimi per Kerkese**), nenkupton qe deshtimi per te njoftuar Bleresit brenda periudhes se lartpermendur nuk do te ndikojë tek detyrimet e Shitesit per te demshperblyer Bleresin dhe/ose Banken; dhe
- b. Bleresi do t'i jape Perfaqesuesit te Shitesit (per llogari te Shitesit) informacionin e arsyeshem qe mund te kerkojne per ti mundesuar atyre per te hetuar kete Humbje dhe pergjegjesine e mundshme te tyre per sa i perket kesaj Humbje brenda oreve normale te punes.
- 9.5.2 Nese Perfaqesuesi i Shitesit (per llogari te Shitesit) kundërshton Njoftimin per Kerkese, Palet do te tentojne te zgjidhin mosmarreveshjet e tyre ne menyre miqesore, dhe ne rast se nuk arrihet nje marreveshje brenda njezet (20) Dite Pune nga data e marrjes se Njoftimit per Kerkese, konflikti do te zgjidhet ne perputhje me parashikimet e nen-klauzoles 12.1.1 (Arbitrazhi) te kesaj Kontrate.
- 9.5.3 Pagesat nen kete klauzole 9 (Kushtet qe i aplikohen Garantimeve) do te behen ne Euro. [Shuma e Humbjes do te llogaritet ne Leke dhe do te konvertohet ne Euro sipas Kursit te Këmbimit.]



MM

9.5.4 Pagesat nën këtë klauzole 9 (Kushtet që i aplikohen Garantimeve) do të konsiderohen një zvogëlim i Cmimit të Blerjes.

10. DISPOZITA TË NDRYSHME

10.1 Qëllimi i Detyrimeve

10.1.1 Shitësi angazhohet sipas kësaj Kontrate për veten e tij, si dhe për pasuesit e tij.

10.1.2 Kontrata do të vazhdojë në përfitim të pasuesve të Blerësit.

10.2 Konfidencialiteti

10.2.1 Asnjë nga Palët, pa miratimin paraprak me shkrim të Palës tjetër, nuk duhet t'i japë informacion asnjë personi dhe as të bëjë njoftim publik të informacionit në lidhje me ndonjë parashikim të kësaj Kontrate dhe/ose të transaksioneve të parashikuar në të.

10.2.2 Kur njëra nga Palët në mënyrë të arsyeshme përcakton se dhënia e informacionit, ose njoftimi sa më sipër kërkohet me ligj, ose rregullore, apo nga ndonjë autoritet tjetër, subjekt i të cilit është njëra nga Palët, dhënia e informacionit ose njoftimi, për aq sa lejon ligji dhe është llogjikisht e mundshme, do të bëhet pas konsultimit me Palën tjetër.

10.3 Tërësia e Kontratës dhe Ndryshimet

10.3.1 Kontrata dhe Shtojcat si dhe Marreveshja e Aksionereve 2020 përbëjnë kontratën e plotë dhe zëvendëson çdo marrëveshje tjetër më të hershme midis Palëve, që lidhet me çështjen e kësaj Kontrate.

10.3.2 Çdo ndryshim në këtë Kontratë do të jetë i vlefshëm vetëm nëse bëhet me shkrim dhe nënshkruhet nga ose për llogari të secilës Palë dhe në mënyrë të veçantë i referohet kësaj Kontrate.

10.4 Kostot

10.4.1 Secila Palë mbart kostot e saj lidhur me negociatat për lidhjen e kësaj Kontrate dhe Mbylljen e dokumenteve ligjore detyruese për shitjen dhe blerjen.

10.4.2 Çdo detyrim për transferimin, ose për taksën e pullës, që mund të rezultojë si rrjedhojë e nënshkrimit të Kontratës dhe transferimit të Aksioneve, do të mbulohet nga Blerësi.

10.5 Veçueshmëria

Në qoftë se në çdo kohë, ndonjë nga dispozitat e kësaj Kontrate bëhet e pavlefshme, ose e pazbatueshme, atëherë kjo dispozitë do të konsiderohet veçmas nga kjo Kontratë dhe nëse është e mundur, do të zëvendësohet me një dispozitë të ligjshme, e cila të jetë sa më afër me qëllimin e Palëve nën këtë Kontratë dhe, ku të jetë e mundur, të mos ndikojë, ose të dëmtojë vlefshmërinë, ose zbatueshmërinë e dispozitave të tjera të kësaj Kontrate.

10.6 Tjetërsimi

10.6.1 Kjo Kontratë do të jetë e detyrueshme dhe do të hyjë në veprim për përfitimet e pasardhëseve të Palëve, por nuk do të jetë e tjetërsueshme pa miratim paraprak me shkrim nga Palët e tjera.

23




127

10.6.2 Pavarësisht si me lartpermendur, Bleresi ka te drejte te t'ia tjetersoje kete Kontrate nje kompanie tjeter te grupit te tij SHA.

10.7 Vazhdimësia e Kontratës pas Mbylljes

Garancite dhe parashikimet e tjera të kësaj Kontrate, të cilat nuk janë zbatuar deri në Datën e Mbylljes, do të mbeten në fuqi dhe efekt, pavarësisht Mbylljes.

10.8 Jo Partneritet ose Agjenci

Asgjë ne kete Kontrate (apo ne ndonje nga marreveshjet e percaktuara ketu) nuk do te konsiderohet se perben nje partneritet ndermjet Paleve dhe, pervec kur shkruhet shprehimisht, nuk percanton ndonje Pale agjentin e Pales tjeter per ndonje qellim.

10.9 Të Drejtat dhe Çështje të tjera

10.9.1 Të drejtat, autoriteti, privilegjet dhe ndreqjet ligjore të parashikuara në këtë Kontratë janë kumulative dhe nuk janë të kufizuara në të drejtat, autoritetet, privilegjet, ose ndreqjet ligjore të cilat parashikohen nga ligji, apo ndryshe.

10.9.2 Asnjë dështim, apo vonesë në ushtrimin e të drejtave, autoritetit, privilegjit, ose ndreqjeve ligjore sipas kësaj Kontrate, nuk do të prekë, apo të ndikojë në ndonjë mënyrë në ushtrimin e tyre dhe nuk do të përbëjë heqje dorë prej tyre në tërësi, ose pjesërisht.

10.9.3 Ushtrimi i vetëm, ose i pjesshëm i të drejtave, autoritetit, privilegjit, ose ndreqjeve ligjore sipas kësaj Kontrate, nuk do të ndalojë ushtrimin e mëtejshëm të të drejtave të tjera, autoritetit, privilegjit, ose ndreqjeve ligjore.

10.10 Sigurim i Mëtejshëm

Në çdo kohë pas kësaj date, Shitësi, me kërkesën dhe shpenzimet e Blerësit, do të nënshkruajë, apo sigurojë nënshkrimin e këtyre dokumenteve dhe do të kryejë, ose sigurojë kryerjen e veprimeve, të cilat mund të kërkojnë nga Blerësi me qëllim marrjen e të drejtave të pronësisë mbi Aksionet nga Blerësi dhe kalimin tek Blerësi të përfitimeve të plota, që burojnë nga të gjitha parashikimet e kësaj Kontrate.

10.11 Ndreqjet Ligjore

Blerësi njeh dhe pranon se, përsa u përket shkeljeve të Garancive, apo të parashikimeve të tjera të kësaj Kontrate, dëmshpërblimi do të jetë ndreqja e vetme.

10.12 Gjuha

10.12.1 Kjo Kontratë është hartuar në gjuhën angleze në 5 kopje dhe më pas është përkthyer në gjuhën shqipe. Palet do ta nënshkruajnë në shqip, por në rast mospërputhje, versioni në gjuhën angleze do të kete perparesi.

10.13 Perfaqesuesi i Shitesit

10.13.1 Duke nënshkruar kete Kontrate, Shitesi cakton dhe emeron ketu ne menyre te pakthyeshme z. Mohamad Al-Midani si perfaqesuesin e Shitesit, me fuqi dhe autoritet te plote per te vepruar ne emer



dhe per llogari te ketij Shitesi per sa i perket te gjitha ceshtjeve qe linden ne lidhje me kete Kontrate dhe Marreveshjen Escrow ku ky Shites eshte pale dhe transaksionet e percaktuara ne keto marreveshje.

- 10.13.2 Perfaqesuesi i Shitesit emerohet ketu (i) agjenti i Shitesit, me fuqi te plote zevendesimi dhe me kapacitet dhe autoritet te plote ne diskrecionin e tij te vetem, per te vepruar ne emer dhe per llogari te Shitesit ne lidhje me te gjitha ceshtjet qe linden, rezultojne, parashikohen ose lidhen me kete Kontrate dhe Marreveshjen Escrow, nese jane te zbatueshme, dhe (ii) agjenti per sherbimin e procesit per Shitesin, dhe Shitesi ketu jep miratimin e parevokueshem ndaj sherbimit e ndonje dhe cdo procesi, ne cdo veprim ose procedure qe lind dhe lidhet me kete Kontrate nga permbushja e ketij procesi nga Perfaqesuesi i Shitesit.
- 10.13.3 Bleresi do te kete te drejten dhe autoritetin absolut te mbeshtetet tek veprimet ose mosveprimet e ndermarra nga Perfaqesuesi i Shitesit per llogari te Shitesit, dhe Bleresi nuk ka per detyre te hetoje veprimet ose mosveprimet e Perfaqesuesit te Shitesit.
- 10.13.4 Ne rast se Perfaqesuesi i Shitesit refuzon ose nuk eshte me ne gjentje per te vepruar si Perfaqesues i Shitesit, Shitesi do te caktojte pa vonese nje tjetër Perfaqesues te Shitesit dhe do te jete me pas nje Perfaqesues i Shitesit pasardhes, dhe Perfaqesuesi i Shitesit do te jete ne sherbim derisa pasardhesi te emerohet dhe kualifikohet per te vepruar sic percaktohet ketu.

11. NJOFTIMET

Përvec rastit kur është pranuar ndryshe, të gjitha njoftimet dhe komunikimet për secilën Palë do të bëhen me shkrim në gjuhën angleze dhe ose do të: (i) dërgohen personalisht, ose (ii) me postë të regjistruar, ose (iii) me telekopje të konfirmuar me poste të regjistruar, dërguar me email, i cili do të konsiderohet i marre 12 ore pas dergimit, ose (iv) me korrier në adresat si më poshtë, ose në ndonjë adresë tjetër të njoftuar me shkrim:

- (a) Për Blerësin: EUROSIG SH.A.

Ne vemendje te: Z. Kadri MORINAJ

e-mail: kadrinorinaj@eurosig.al

- (b) Për Përfaqësuesin e Shitesit

Ne vemendje te: Z. Mohamad Al-Midani

e-mail/Fax: mmidani@isdb.org

kopje per: MChatti@isdb.org

- 11.1.2 Njoftimet do të konsiderohen të marra nga Pala të cilës i është drejtuar: (i) ditën e dërgimit, nëse është dërguar personalisht, ose me korrier, ose (ii) në datën e treguar në faturën e konfirmimit të nënshkruar, për dërgesat me postë të regjistruar, ose (iii) në datën e marrjes së telekopjes (raporti i transmetimit do të jete deshmi e mjaftueshme e dorezimit), per telekopjet e konfirmuara me poste te regjistruar.

12. LIGJI I ZBATUESHËM DHE ARBITRAZHI

12.1 Ligji i Zbatueshëm

25




Përveç dispozitave të detyrueshme të ligjeve të Republikës së Shqipërisë, kjo Kontratë do të udhëhiqet nga dhe do të interpretohet në përputhje me ligjin e Dubai International Financial Center (DIFC).

12.2 Arbitrazhi

- 12.2.1 Palët pranojnë t'ia paraqesin për zgjidhje arbitrazhit çdo mosmarreveshje në lidhje me vlefshmërinë, interpretimin, ose zbatimin e Kontratës.
- 12.2.2 Të gjitha mosmarreveshjet në lidhje me këtë Kontratë do të zgjidhen sipas Rregullave të Arbitrazhit të Qendres së Arbitrazhit DIFC-LCIA, Rregulla, të cilat konsiderohen të përfshirë duke iu referuar atyre në këtë Nen 12.1.1.
- 12.2.3 Selia e arbitrazhit do të jetë DIFC (Dubai, U.A.E).
- 12.2.4 Gjuha në të cilën do të zhvillohet procedura e arbitrazhit do të jetë gjuha angleze dhe provat, si dhe memorandumit për arbitrat, do të relatohen në gjuhën angleze. Vendimi përfundimtar nga gjykata e arbitrazhit do të jepet në gjuhën angleze.

Unë, Noteri Publik, pasi u lexova me zë përmbajtjen e plotë të kësaj Kontrate Palëve, në praninë e përkthyesit të gjuhës angleze, pranoj se Kontrata është në përputhje me vullnetin e tyre të plotë dhe të lirë, pasi u nënshkrua në praninë time, unë vërtetoj nënshkrimin sipas ligjit shqiptar.




Nenshkrues nga Xhevdet KOPANICCEO
Per llogari te EUROSIG SH.A

Perkthyes:



Thodhori Kamberi



Nenshkrues nga Mohamad Al-Midani
Per llogari te IsDB

NOTERI





LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca 2.1.1: Numri i Aksioneve te zoteruara pas realizimit te kesaj Kontrate:

Emri i Aksionerit	Numri i Aksioneve	Kapitali i paguar ne LEK	Perqindja
Islamic Development Bank	248,613	800,543,555.91	42.204%
Eurosig	300,528	967,711,880.59	51.017%

Shtojca 4.1.1 (d): Lista e Autorizimeve te kerkuara

Shtojca 2. Llogarite

Shtojca 3. Permbajtja e Skedulit te Marreveshjes Escrow

Shtojca 4. Vendimet nga organet kompetente vendimmarrese te Bleresit dhe Shitesit qe miratojne Kontraten.

HM

27




Shareholders Table of UBA Bank, after the purchase of 30% additional shares of IsDB or 176,761 shares according to the notary Share Purchase Agreement dated 07/07/2021

No.	Names of Shareholders	Number of shares	Paid up capital in US\$	Paid up capital in Lek	Nominal Value per share in US\$	Percentage of participation
1	Islamic Development Bank	248,613	\$ 5,969,198	800,543,555.91	24.010	42.204%
2	EUROSIG SH.A.	300,528	\$ 7,215,677	967,711,880.59	24.010	51.017%
3	Ithmaar Bank (Shamil Bank of Bahrain)	25,346	\$ 608,557	81,615,108.49	24.010	4.303%
4	Saudi Brothers Commercial Co.	3,168	\$ 76,064	10,201,083.55	24.010	0.538%
5	Hamed H. Mutabakani	9,306	\$ 223,437	29,965,682.93	24.010	1.580%
6	Hayder Mohamad Awad	1,267	\$ 30,421	4,079,789.41	24.010	0.215%
7	Faisal A. El Khireiji	842	\$ 20,216	2,711,272.84	24.010	0.143%
	Total	589,070	\$ 14,143,571	1,896,828,373.73	24.010	100.000%

134.112

Nominal value per share in Lek: 3,220.039

Note:

After the acquisition of 30% of the additional shares of IsDB by Eurosig, only the participation of the shareholders of IsDB and Eurosig changes and the values of capital paid respectively in lek and euro by them and all others remain unchanged.



Tabela e Aksionereve te BBSH, pas blerjes se 30% te aksioneve shtese te IsDB ose 176,761 aksione sipas Kontrates noteriale per Shitblerjen e Aksioneve date 07/07/2021

Nr.	Emrat e Aksionereve	Numri i Aksioneve	Kapitali i Paguar ne US\$	Kapitali i Paguar ne Leke	Vlera Nominale per aksion ne US\$	Perqindja e pjesemarrjes
1	Islamic Development Bank	248,613	\$ 5,969,198	800,543,555.91	24.010	42.204%
2	EUROSIG SH.A.	300,528	\$ 7,215,677	967,711,880.59	24.010	51.017%
3	Ithmaar Bank (Shamil Bank of Bahrain)	25,346	\$ 608,557	81,615,108.49	24.010	4.303%
4	Saudi Brothers Commercial Co.	3,168	\$ 76,064	10,201,083.55	24.010	0.538%
5	Hamed H.Mutabakani	9,306	\$ 223,437	29,965,682.93	24.010	1.580%
6	Hayder Mohamad Awad	1,267	\$ 30,421	4,079,789.41	24.010	0.215%
7	Faisal A. El Kherei	842	\$ 20,216	2,711,272.84	24.010	0.143%
Total		589,070	\$ 14,143,571	1,896,828,373.73	24.010	100.000%

134.112 Vlera nominale per aksion ne Leke: 3,220.039

Shenim:

Pas blerjes se 30% te aksioneve shtese te IsDB nga Eurosig, vetem pjesemarrja e aksionereve IsDB dhe Eurosig ndryshon si dhe vlerat e kapitalit te paguar respektivisht ne leke dhe euro nga ata, ndersa te gjithe te tjeret mbeten te pa ndryshuar.

